



OSHEE GROUP sh.a njofton mbi hapjen e vendeve vakante **Lexues** pranë OSSH sh.a.

LEXUES

Detyrat dhe përgjegjësitë:

- Kryen leximin e rregullt të konsumatorëve dhe foto të matjes duke respektuar grafikun e leximit të miratuar më parë.
- Regjistron leximet në kompjuterin personal portativ (PDA) dhe i ngarkon ato në sistemin qendror të të dhënave.
- Angazhohet maksimalisht për të realizuar leximin e matësit duke koordinuar orar tjetër në raste se objekti rezulton i pa-aksesueshëm sipas grafikut.
- Identifikon dhe raporton nëpërmjet PDA, në programin e leximit mobiread, anomalitë e konstatuara gjatë procesit të leximit dhe është përgjegjës për cilesinë/saktësinë e të dhënave.
- Verifikon leximet në rast kur konsumi duket që ka ndryshime të mëdha nga të mëparshmet.
- Inspekton matësat për lidhje të pa-autorizuara, difekte dhe dëmtime (edhe të elementeve të sigurisë) dhe raporton ato eprorit të drejtpërdrejtë.
- Kryen rilexime të konsumatorëve brenda muajit sa herë që kërkohen.
- Raporton tek eprori i drejtpërdrejtë rastet problematike gjatë procesit të leximit të pa përfshira në kodet e anomalive.
- Merr pjesë në ndërprejen e energjisë për konsumatorët debitorë dhe ri-lidhjen në rast shlyerje të detyrimeve.
- Monitoron funksionimin PDA dhe siguron përdorimin në mënyrën e duhur të saj. Raporton difekte dhe problematika të punonjësit e ngarkuar për mirëmbajtjen.
- Është bashkpërgjegjës për humbjet në rrjet.
- Mirëmban dhe përditëson të dhënat mbi adresën e konsumatorëve pjesë të grafikut që mbulon së bashku me të dhënat mbi vendndodhjen e matësit.
- I jep përgjigje pyetjeve të konsumatorëve mbi shërbimet, tarifat ose i orienton ata të kontaktojnë Kujdesin Ndaj Klientit duke demonstruar një qëndrim që klientët janë gjithmonë të parët.
- Detyra të tjera, të ngarkuara nga Eprori i drejtpërdrejtë.

Kualifikimet dhe kërkesat:

- Zbatimi i grafikut të leximit.
- Përbushjen e detyrave dhe proceseve të punës që kanë ndikim direkt në rritjen e arkëtimeve dhe reduktimi i humbjeve teknike dhe jo-teknike (komerciale).



- Kryerjen e saktë të leximit dhe në kohë shoqëruar 100% me foto korrekte (numri i faturave 0 dhe gabimeve në lexim).
- Nivel i ulët i anomalive.
- Raportimi korrekt i anomalive.
- Raportimi i rasteve që kanë nevojë për përditësim.
- Konstatimi i rasteve me lidhje të pa-autorizuara dhe problematike.

.

Të gjithë kandidatët e interesuar janë të lutur të bëjnë aplikimin në websiten e OSHEE group, në portalin e punësimit.

Ju njoftojmë se vetëm kandidatët e përzgjedhur do të ftohen për intervistë.